Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**20.10.2023**	**01.11.2023**	**2023/0784**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.10.2023, OE "TERMOMONTIMI"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0784, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "TERMOMONTIMI"- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i palestres ne Zahaq RITENDER" me nr. të prokurimit: "635-23-3456-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0784 i dt:12.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve – LPP

RROUP 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

1. Argumenti I parë

Në dosjen e tenderit është kërkuar:

3	**Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit te kontratës minimum 150 dite deri ne max 250 ditë**	Pikët <100x 30%> për tenderin me periudhe me te gjate garantuese. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	30%	$G = \frac{Gt}{Gs} x [100x\%]$
			100 %	

Në dosjen e tenderit është kërkuar 150 ditë. Fjala ditë sipas dosjes së tenderit nënkupton ditë kalendarike

1.5 Përgjatë kësaj Dosje të Tenderit:

a) shprehja "me shkrim" kuptohet komunikimi në formë të shkruar (p.sh. me e- mail, faks, teleks) me dëshmi të pranimit;
b) nëse konteksti kërkon "njëjës" gjithashtu nënkupton "shumës" dhe anasjelltas;
c) "ditë" nënkupton ditën kalendarike;
d) ju jeni të referuar si "operator ekonomik" apo "tenderues" dhe
e) lëshuesi i kësaj dosje të tenderit referohet si "autoritet kontraktues".

2. Qëllimi i Kontratës 2.1 Klasifikimi i Përgjithshëm i Fjalorit të Prokurimit dhe qëllimi i kontratës **janë të shënuara në FDT.**

PLANI DINAMIK "HARST Group"Sh.p.k.

Autoriteti: Komuna e Pejes

Ndërtimi i palestres në Zahaq RITENDER

Plani Dinamik 150 ditë Pune

OE I rekomanduar për kontratë ka paraqitur planin dinamik 150 ditë pune. Meqense dita e shtune dhe e diele janë ditë pushimit atëhere konsiderohet se OE në fjale ka përpiluar planin dinamike në 190 ditë kalendarike.

Nga perllogaritja e pikeve I bie që ne si OE Termomontimi SH.P.K te kemi me shume pikë sesa OE I rekomanduar për kontratë.

Vendos te dhenat e OE				
Koeficienti	0.5	0.3	0.2	
Operatori Eknomik	Çmimi	Afati Kohor - Dite kalendarike	Periudha Garantuese - Vite	
GEO HARST Group SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K.; NIVA Construction ' SH.P.K	855,855.00 €	190 (OE ka perpiluar planin dinamik 150 dite pune, qe I bie 190 dite kalendarike)	6	
OE Termomontimi SH.P.K	855,253.90 €	150	5	
	Pesha/Çmimi	Pesha/Afati	Pesha/Periudha Garantuese	Totali
GEO HARST Group SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K.; NIVA Construction ' SH.P.K	49.96	23.68	20	93.64
OE Termomontimi SH.P.K	50	30	16.67	96.67

2. Argumenti i dytë

Në dosjen e tendrit është kërkuar:

2.3 Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës (drejtimi energjetike) me minimum 5 vite përvojë pas diplomimit. I certifikuar per efiçience te energjise.	**2.3 Diploma (e noterizuar) dhe çertifikata për efiçiencë të energjisë nga institucioni I akredituar (e noterizuara), dhe Cv e nenshkruar nga vet inxhinieri. Kontrata pune valide të noterizuara (OE dhe nga inxhinieri).**

OE i rekomanduar për kontratë si dëshmi për këtë kriter ka paraqitur dy inxhiniera të elektros.

1. Skender Nitaj

Ky person është inxhinier e elektroteknikes **drejtimi Elektronike**, ndërsa në dosjen e tenderit është kërkuar **drejtimi Energjetike**. Pra, nuk përmbushet kriteri I dosjes se tenderit.

2. Sahit Hasani

Ky person është inxhinier I elektroteknikes drejtimi Energjetike, por **nuk është I çertifikuar për efiçience te energjise** sipas kërkesës së DT.

Pra, kriteri I dosjes se tenderit për inxhinierin e elektroteknikes drejtimi energjetike I çertifikuar për efiçiencë të energjisë nuk përmbushet.

Në këtë procedurë të prokurimit kemi shkelje të LPP Neni 71, dhe Neni 59.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar asnjë pikë te **Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve** të **Rregullore Nr. 001/2022** për prokurimin publik.

40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së, përfshirë një urdhër për ri-vlerësim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit
b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet përcaktuara në dosje të tenderit;
c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

40.13 AK do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Kërkojme nga OSHP qe te anulohet vendimi I dates 26.09.2023 dhe lenda te kthehet ne rivleresim.

KRITERET PËR VLERËSIM

2.3 Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës (drejtimi energjetike) me minimum 5 vite	të dy palët (OE dhe nga inxhinieri). 2.2 .Diploma (e noterizuar), I	

15

përvojë pas diplomimit. I certifikuar per efiçience te energjise.	çertifikuar për sistem të menaxhimit dhe shëndetit në pune (Te noterizuara),	

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

26.09.2023 Pejë

KOMUNA E PEJES, Hasan Prishtina, PN 30000 Pejë

O.E: TERMOMONTIMI

Nr i Prokurimit	**635-23-3456-5-1-1**
Nr i brendshëm	**635-23-032-511**

Titulli: Ndërtimi i palestres në Zahaq RITENDER RIVLERSIM

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".
Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.
Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj ***nuk qe tenderi me çmimin ekonomikisht me te favoreshem*** në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.
Ju informojmë se kontrata i është dhënë **HARST Group SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K.; NIVA Construction ' SH.P.K ne vlere totale te ofertes 855.855.00 €** **(99.96 pikë)**
Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejes me daten 13.09.2023 ka pranuar vendimin nga Organi Shqyrtues i OSHP-se me numer te ankeses 2023/0401, dhe baze vendimit te mare nga OSHP-ja ne si A.K kemi vepruar konform vendimit te tyre kemi kthyer lenden ne RI-VLERSIM dhe oferta juaj eshte e pa suksesheme pasi qe gjate Ri-Vlersimi ju keni marur gjithesej 96.67 Pike ndersa O,E fitues ka marur 99.96 pike

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit*.
Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .
Njoftimi i dhënies së kontratës është i publikuar ne platformën elektronike.Me respekt,

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

VENDIMI I OSHP nr.401/23

Ankuesi, ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i eliminuar të tij/sajë se (sipas AK) se OE nuk plotëson kërkesën për "Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës (drejtimi energjetike) me minimum 5 vite përvojë pas diplomimit. I certifikuar për efiçience te energjisë.". Eksperti shqyrtues pas analizimit të ofertës së OE ankues ka gjetur se për këtë kërkesë përveç personave te kontestuar nga AK, OE ka ofruar dëshmi për z. Shabani i cili plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Po ashtu edhe z.Nitaj ka ofruar dëshmitë në pajtim me kërkesat e dosjes Dmth. Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës dhe certifikatën për efiqencë. AK po ashtu ka mund që në pajtim me nenin 72 të kërkoj sqarime shtesë për personat e kontestuar që janë marr si arsye për eliminim, kështu që për ekspertin shqyrtues pretendimin ankimor i bazuar dhe se OE plotëson kërkesat e dosjes së tenderit për Inxhinier i Diplomuar elektroteknik i certifikuar për efiqencë. Paneli shqyrtues, duke i analizuar dhe krahasuar pohimet ankimore në raport me ofertën, shpjegimet e ekspertit dhe kërkesat e DT, mendon se zgjidhja më e mirë do të ishte që AK me qëllim të mos diskriminimit apo pabarazisë të kërkoj informacione shtesë konform nenit 72 të LPP, nëse është e nevojshme edhe nga institucionet universitare sa i përket inxhinerëve se a i plotësojnë ndonjëri kushtet e Dosjes së Tenderit.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se OE i rekomanduar për kontratë për z Hajdari, certifikatën e efiqencës nga SEEK ku trajnues ka qenë GFS Consulting nuk e plotëson kërkesën e AK-së për certifikim në efiqencë. Eksperti shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se certifikatat për efiqencë të energjisë në Kosovë lëshohen nga Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri pran Universiteti Hasan Prishtina së bashku me Ministrinë e Ekonomisë – Agjencia e Kosovës për Efiqencë të Energjisë dhe trajnimi zgjat për mbi 1 muaj, dhe përfshinë leksionet, auditimin në terren, përgaditjen e raportit të auditimit të energjisë dhe provimin bazuar standardin DIN EN 16247 për efiqencë të energjisë, ndërsa OE i rekomanduar ka ofruar certifikatë të një kursi dy ditorë të lëshuar nga SEEK dhe kursi është mbajtur nga GFA Consulting Grup, kështu që sipas mendimit të ekspertit është se certifikata e kursit dy ditor e mbajtur nga GFA consultin Group dhe e lëshuar nga SEEK nuk plotëson kërkesën Certifikim në Efiqencë të energjisë pasi një certifikim i tillë bëhet nga institucionet vendore përkatëse të për shkruara më lart. Paneli shqyrtues, këtë pretendim nuk mund ta konstatoj por duke i analizuar dhe krahasuar pohimet ankimore në raport me ofertën, shpjegimet e ekspertit dhe kërkesat e DT, obligon AK që në fazën e ri-vlerësimit ta bëjë edhe këtë verifikim qoftë tek institucionet tjera rreth nxjerrjes së kësaj çertifikate dhe AK ta vlerëson përfundimisht se OE në fjalë a i ka ofruar dëshmitë konform kërkesave të Dosjes së Tenderit.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **TERMOMONTIMI**

Pretendimi nr.1

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar planin dinamik në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore, arsyetimit të AK-së dhe ofertës së OE të rekomanduar, kemi gjetur se I njëjti në planin dinamik në total ka 150 ditë.

Provë : Plani dinamik në ofertë të OE të rekomanduar.

I njëjti plan dinamik sipas tabelës së plotësuar nga OE pavarsisht shprehjes së përdorur nga OE para fillimit të tabelës "150 ditë pune", I njëjti plan nuk parasheh ditë shtesë apo ditë "jo pune".

Për më tepër, me qëllim të trajtimit të barabartë të OE-ve, ne kemi analizuar edhe ofertën e OE e ankues, e cila sipas vlerësimit tonë është plotësuar në mëyrë të njëjt, dmth duke mos parashikuar ditë "jo pune" dhe në toal ka 150 ditë, njëjt si OE ankues

Përveq kësaj në këkesa decidive në dosje të tenderit ka qenë sin ë vijim :

"Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: minimim 150 dit deri ne max 250 dit kalendarike".

Përveç kësaj kjo dëshmohet edhe përmes deklaratës së aneksi 7 deklarata e OE për afatin e implementimit të projektit dhe periudhën garantuese, ku decidivsht shënon afati i implementimit të këtij projekti është 150 ditë nga data e fillimit të punëve dhe 6 vite (maksimumi i mundshëm) periudha garantuese.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pabazuar.

Pretendimi nr.2

Pretenmdimi i dytë ankimnorë është se OE i rekomandua rpër kontratë : kriteri i dosjes se tenderit për inxhinierin e elektroteknikes drejtimi energjetike I çertifikuar për efiçiencë të energjisë nuk përmbushet.

Sipas OE ankues OE i rekomanduar për kontratë si dëshmi për këtë kriter ka paraqitur dy inxhiniera të elektros.

1. Skender Nitaj

Ky person është inxhinier e elektroteknikes drejtimi Elektronike, ndërsa në dosjen e tenderit është kërkuar drejtimi Energjetike. Pra, nuk përmbushet kriteri I dosjes se tenderit.

2. Sahit Hasani

Ky person është inxhinier I elektroteknikes drejtimi Energjetike, por nuk është I çertifikuar për efiçience te energjise sipas kërkesës së DT.

Duhet të sqarojmë se OSHP përmes bvendimit 401/23, ka obliguar AK-në që për këtë qështje të kërkoj sqarime nga insitucionet univerisitare.

Nga shkresat lëndës nuk kemi gjetur se dëshmi se AK ka ndërmarr një veprim të tëillë, andaj konsiderojmë se vendimi i AK-së nuk është marr në pajtim me kërkesat e vendimit të OSHP 401/23.

Po ashtu nuk kemi gjetur dëshmi se AK ka kërkuar sqarime sipas vendimit të OSHP-së 401/23 sa i përket certifimit për efiqencë të energjisë të inxhinierit te OE (tani ankues), andaj edhe në këtë pikë vendimi i AK-së nuk është marr në pajtim me obligimet e caktuara nga OSHP me vendimin 401/23.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **TERMOMONTIMI**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Ilir Halili